

RREGULLORE SHKOLLORE

Parandalimi i konflikteve ndërmjet nxënësve në shkolla

Shembull nga komuna e Dardanës

Neni 1 - Qëllimi i Rregullores

1. Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë mënyrën e organizimit, zhvillimit dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve në aktivitete jashtëkurrikulare, me qëllim të promovimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse, zhvillimit të kompetencave kyçe, uljes së rrezikut për braktisjen e shkollës, dhe përmirësimin të mirëqenies dhe performancës akademike të nxënësve.

Neni 2 - Baza Ligjore

1. Dokumenti mbështetet në një kornizë ligjore dhe udhëzime të qarta të përcaktuara nga aktet nënligjore dhe korniza edukative në Republikën e Kosovës, me qëllim sigurimin e cilësisë dhe standardeve të larta në organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare. Ajo është ndërtuar mbi:

- 1.1. Parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;
- 1.2. Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 21/2013 për Organizimin e Aktiviteteve Jashtëkurrikulare;
- 1.3. Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2018 për Vlerësimin e Nxënësve në Arsimin Parauniversitar;
- 1.4. Kornizën e Kurrikulës së Kosovës;
- 1.5. LIGJI NR. 06/L-082 Për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 3 - Përkufizime

1. Bazuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës aktivitetet jashtëkurrikulare janë aktivitete edukative, kulturore, artistike, sportive, sociale apo të tjera që organizohen jashtë orarit të rregullt mësimor, me pjesëmarrjen vullnetare të nxënësve por që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave.

2. Me vendim të drejtorit, shkolla mund të caktojë një anëtar të stafit pedagogjik si Koordinator të Aktiviteteve Jashtëkurrikulare. Ky mësimdhënës është përgjegjës për planifikimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e këtyre aktiviteteve, në bashkëpunim me Këshillin Drejtues, Koordinatorin e cilësisë, Këshillin e Nxënësve, psikologun dhe pedagogun e shkollës.

3. Në mungesë të këtij koordinatori, drejtori i shkollës ose një grup i stafit pedagogjik mund të marrë përgjegjësinë.

Neni 4 - Parimet Udhëzuese

1. Aktivitetet jashtëkurrikulare në shkollë duhet të organizohen dhe zhvillohen në përputhje me një qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, që garanton cilësi, koherencë dhe barazi në pjesëmarrje:

1.1. Të jenë të qasshme për të gjithë nxënësit pa dallim të përkatësisë etnike, racore, gjinore, arritjes akademike, nevojave të veçanta dhe gjendjes socio-ekonomike;

1.2. Të pasqyrojnë interesat, nevojat dhe preferencat e nxënësve;

1.3. Të kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të tyre sociale, emocionale dhe akademike;

1.4. Të promovojnë gjithëpërfshirjen, barazinë dhe vullnetarizmin;

1.5. Të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet nxënësve, mësimeve dhe komunitetit.

1.6. Të planifikohen në mënyrë të strukturuar përmes një kalendari vjetor dhe mujor, të miratuar dhe diskutuar me Këshillin Drejtues dhe stafin pedagogjik të shkollës;

1.7. Të kenë qëllime të qarta edukative dhe përmbajtje të përshtatshme për grupmoshën dhe kontekstin e nxënësve;

1.8. Të kenë të caktuar persona përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të çdo aktiviteti;

1.9. Të dokumentohen në mënyrë të rregullt, duke reflektuar mbi pjesëmarrjen, gjithëpërfshirjen dhe rezultatet e arritura;

1.10. Të lidhen me qëllimet edukative dhe zhvillimore të shkollës, në harmoni me kurrikulën bërthamë dhe prioritetet e komunitetit shkollor.

Neni 5 - Llojet e Aktiviteteve Jashtëkurrikulare

1. Aktivitetet jashtëkurrikulare janë të llojllojshme dhe mund të klasifikohen sipas natyrës dhe qëllimeve të tyre. Ato kontribuojnë në mënyra të ndryshme në zhvillimin gjithëpërfshirës të nxënësve, duke nxitur angazhim, aftësi sociale dhe ndjenjë përgjegjësie qytetare. Disa nga llojet e aktiviteteve jashtëkurrikulare:

1.1. Aktivitete të lira edukative

1.1.1. Arte të bukura, fotografi, ese, aktivitete sportive, kor, revista të shkollës, radio të shkollës, televizion të shkollës);

1.1.2. Klube si: klubi i shkencës, klubet e artit dhe klubet sportive;

1.2. Aktivitete kulturore dhe artistike

1.2.1. Vizita në muze, parqe, natyrë, vende historike, institucione;

1.2.2. Vizita të tjerëve në shkollë (diskutime me të ftuar, udhëheqës të bashkësisë, prindër, përfaqësues të bizneseve, lokale, politikanë, njerëz të mediave, mjekë, profesorë universitarë etj).

1.3. Aktivitete sportive:

1.3.1. Futboll, basketboll, volejboll dhe hendboll;

1.3.2. Atletikë;

1.3.3. Ecje malore dhe shëtitje në natyrë;

1.3.4. Sporte dimërore.

1.4. Aktivitete të shërbimit komunitar dhe vullnetarizmit;

1.4.1. Punë vullnetare për të ndihmuar moshatarët e tyre në nevojë, pleqtë e vetmuar, familjet e varfëra të komunitetit përmes grumbullimit të ndihmës në ushqime, veshmbathje, mjete materiale;

1.4.2. Punë vullnetare në organizimin e aktiviteteve të ndryshme në kuadër të shkollës;

1.5. Aktivitete për promovimin e shëndetit dhe mbrojtja e mjedisit

1.5.1. Përmes aktiviteteve të lira, fushatave të vetëdijësimit;

1.5.2. Aktivitete për mbrojtjen e mjedisit;

1.5.3. Iniciativa për gjelbërimin e mjediseve përreth.

Neni 6 - Planifikimi dhe Organizimi

1. Organizimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare në shkollë kërkon planifikim të mirëfilltë dhe bashkëpunim ndërmjet të gjithë akterëve. Hapat kryesorë që duhet të ndjekë shkolla për të siguruar mbarëvajtjen dhe efektivitetin e këtyre aktiviteteve:

1.1. Duhet të hartohet kalendari vjetor i aktiviteteve jashtëkurrikulare;

1.1.1. Kalendarin e harton një anëtar i stafit pedagogjik i caktuar nga drejtoria e shkollës (p.sh. koordinatori/ja i/e aktiviteteve jashtëkurrikulare- një mësues/mësuese i caktuar për këtë detyrë), në bashkëpunim me Këshillin e Nxënësve, Koordinatorin e cilësisë dhe me mbështetjen e stafit pedagogjik-psikologun dhe pedagogun e shkollës. Drafti i kalendarit prezantohet për shqyrtim dhe aprovim në Këshillin Drejtues të Shkollës, në përputhje me objektivat edukative dhe planin zhvillimor të shkollës jo më vonë se në takimin e parë të Këshillit Drejtues të Shkollës, më së largu deri në muajin nëntor të çdo viti shkollor.

1.2. Psikologu, pedagogu shkollor dhe koordinatori i cilësisë mund të kontribuojnë në mënyrë mbështetëse në aktivitetet jashtëkurrikulare, pa ndërhyrë në rolet organizative. Ata ofrojnë këshilla për përshtatshmërinë psiko-sociale të aktiviteteve, ndihmojnë në promovimin e gjithëpërfshirjes dhe mirëqenies së nxënësve, si dhe marrin pjesë në reflektime mbi efektivitetin dhe cilësinë e aktiviteteve, në përputhje me mandatin e tyre profesional dhe funksionet që kanë brenda shkollës.

1.3. Çdo aktivitet duhet të ketë një qëllim të qartë edukativ dhe të përshkruhet me kohëzgjatjen, target-grupin dhe udhëheqësin përgjegjës.

1.4. Të gjitha aktivitetet jashtëkurrikulare duhet të dokumentohen dhe të raportohen në mënyrë periodike nga koordinatori/ja për aktivitete jashtëkurrikulare te drejtori i shkollës në përputhje me formatin dhe afatet e përcaktuara nga shkolla.

Neni 7 - Roli i Këshillit të Nxënësve

1. Pjesëmarrja aktive e nxënësve në jetën shkollore përmes Këshillit të Nxënësve është thelbësore për zhvillimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare që i përgjigjen interesave dhe nevojave të tyre. Përgjegjësitë dhe të drejtat kryesore të Këshillit të nxënësve në këtë proces janë:

1.1. Të drejtë të propozojë, organizojë dhe bashkëorganizojë si dhe të vlerësojë dhe bashkëvlerësojë aktivitetet jashtëkurrikulare.

1.2. Përfaqësues i Këshillit të Nxënësve duhet të përfshihet në hartimin e planit të aktiviteteve së bashku me të gjithë akterët e shkollës të përfshirë në këtë proces që të angazhohen në diskutim dhe vendimmarrje për planifikimin, përmirësimin apo ndryshimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare.

Neni 8 - Pjesëmarrja dhe Gjithërfshirja

1. Për të siguruar një mjedis të barabartë dhe nxitës për të gjithë nxënësit, organizimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare duhet të promovojë:

1.1. Pjesëmarrjen vullnetare, duke siguruar që nxënësit të kenë mundësi të informohen dhe të ftohen të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të rregullt, pa detyrim apo përjashtim të tërthortë;

1.2. Qasje gjithëpërfshirëse, duke u siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë të hapura dhe të përshtatshme për të gjithë nxënësit pa dallim të përkatësisë etnike, racore, gjinore, arritjes akademike, nevojave të veçanta dhe gjendjes socio-ekonomike.

1.2.1. Përmbajtja e aktiviteteve të jetë kulturore dhe gjuhësisht e ndjeshme ndaj diversitetit të nxënësve.

1.2.2. Gjuha e përdorur në komunikime, njoftime dhe materiale të jetë e qasshme për të gjitha gjuhët që përdoren në shkollë;

1.2.3. Zgjedhja e përmbajtjes dhe formatit të aktivitetit të jetë e përshtatshme dhe inkurajuese për të gjitha gjinitë;

1.2.4. Ambientet dhe aktivitetet të jenë fizikisht të qasshme për të gjithë nxënësit, me vështirësi në lëvizje apo nevoja të tjera të veçanta;

1.2.5. Përshtatja e orarit, në mënyrë që nxënësit që vijnë nga larg, ose që kanë angazhime të tjera, të mos përjashtohen nga pjesëmarrja;

1.2.6. Sigurimi i mbështetjes shtesë, si ndihma nga asistentë për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore ose mbështetje psiko-sociale kur kërkohet;

1.2.7. Përfshirja aktive e nxënësve në planifikim, për të pasqyruar interesat dhe zërin e tyre në aktivitetet.

Neni 9 - Vlerësimi i Aktiviteteve

1. Pjesëmarrja në aktivitetet jashtëkurrikulare pasqyrohet në mënyrë të strukturuar në procesin e vlerësimit, në përputhje me politikat e brendshme të shkollës, por duhet të merret parasysh që:

1.1. Aktivitetet jashtëkurrikulare nuk zëvendësojnë notat zyrtare, por pjesëmarrja e dokumentuar merret parasysh nga mësimdhënësit në vlerësimin formativ ose në ndonjë komponent të vlerësimit sipas politikës së brendshme të shkollës.

1.2. Nxënësit mund të kërkojnë që pjesëmarrja në aktivitete të vlerësohet në formën e portofolios apo reflektive, e cila mund të kontribuojë deri në 5% në vlerësimin përfundimtar, sipas specifikës së lëndës dhe aprovimit të mësimdhënësit dhe drejtorit.

1.3. Mësimdhënësit mund të zhvillojnë forma të standardizuara të portofoliovë të aktiviteteve, në mënyrë që vlerësimi të bëhet në mënyrë më të drejtë dhe të dokumentuar për të gjithë nxënësit.

Neni 10 - Mbështetja Institucionale

1. Për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve jashtëkurrikulare, është e rëndësishme që:

1.1. Drejtoria e shkollës të jetë përgjegjëse për sigurimin e resurseve për zhvillimin e aktiviteteve, qoftë financiare, njerëzore apo materiale të nevojshme;

1.2. Drejtoria e shkollës duhet të krijojë marrëveshje bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile, biznese lokale apo institucione të tjera për realizimin e aktiviteteve;

1.3. Drejtoria e shkollës mund të ofrojë udhëzime të thjeshtuara për hartimin e portofolios dhe përfshirjen e aktiviteteve në vlerësimin formativ;

1.4. Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) mbështet shkollën në zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare përmes trajnimeve, mbështetjes logjistike dhe fondeve:

1.4.1. Trajnime për promovimin e gjithëpërfshirjes, duke përfshirë pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve, përfshirë ata me nevoja të veçanta arsimore;

1.4.2. Trajnime për vlerësimin dhe dokumentimin e zhvillimit të nxënësve përmes portofolios dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare;

1.4.3. Trajnime për organizimin e aktiviteteve joformale dhe të bazuara në interesat dhe nevojat e nxënësve;

1.4.4. Vënien në dispozicion të hapësirave shkollore dhe komunale, si palestra, salla të aktiviteteve, qendra rinore etj;

1.4.5. Pajisjet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve (sportive, kulturore, teknike, kreative);

1.4.6. Transportin për aktivitete që zhvillohen jashtë shkollës;

- 1.4.7. Lehtësimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me organizata të shoqërisë civile, institucione kulturore, sportive, rinore dhe akterë të tjerë lokalë;
- 1.4.8. Ndarjes së fondeve për realizimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare sipas planifikimeve të shkollës;
- 1.4.9. Përkrahjes së shkollave për të aplikuar në projekte komunale apo donacione të tjera, në bashkëpunim me DKA-në.

Neni 11 - Monitorimi dhe Raportimi

1. Në funksion të rritjes së cilësisë së aktiviteteve jashtëkurrikulare dhe të ndikimit të tyre në zhvillimin e nxënësve, shkolla duhet që:
- 1.1. Të sigurojë dokumentim të saktë të pjesëmarrjes së nxënësve në aktivitetet jashtëkurrikulare, përmes listës së pjesëmarrjes, fotografive dhe videove;
- 1.2. Përfshijë në listat e pjesëmarrjes një seksion ku nxënësit ose prindërit/kujdestarët e tyre japin pëlqimin për realizimin dhe përdorimin e fotografive dhe videove gjatë aktiviteteve;
- 1.3. Caktojë mësimdhënësin organizator të aktivitetit, në bashkëpunim me Koordinatorin për Aktivitete Jashtëkurrikulare, si përgjegjës për dokumentimin e aktiviteteve;
- 1.4. Sigurojë që prania e përfaqësuesve të Këshillit Drejtues të Shkollës (KDSH) në aktivitete të jetë opsionale, por e mirëpritur në ngjarje me karakter të veçantë publik, përfaqësues apo festiv, sipas marrëveshjes me stafin organizues;
- 1.5. Monitorojë dhe dokumentojë ndikimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare në zhvillimin personal, social dhe akademik të nxënësve, përmes vëzhgimit, reflektimit dhe vlerësimit të rregullt nga ana e mësimdhënësve dhe vetë nxënësve;
- 1.6. Vlerësojë efektivitetin e përgjithshëm të aktiviteteve jashtëkurrikulare në nivel shkolle, duke analizuar planifikimin, strukturën, pjesëmarrjen dhe realizimin e tyre, me qëllim identifikimin dhe përmirësimin e praktikave në të ardhmen.

Neni 12 - Dispozita të fundit

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zëvendëson çdo udhëzim të mëparshëm në lidhje me organizimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare.

Zbatimi i saj monitorohet nga drejtoria e shkollës dhe raportohet çdo fundvit shkollor.